

Perspektiva e kundërt metodologjike - një qasje e re dhe jodogmatike

Hajdin Abazi Prof. Ass. Dr.

Kolegji AAB

hajdin.abazi@aab-edu.net

Abstrakt

Tema që do të shtjellohet këtu e vë në fokus qasjen e kundër-induksionit - kushtet, rrethanat dhe nxitjet që bën Feyerabendin ta konstituonte atë, si dhe rolin iluminues që ajo luan, përkatësisht do të duhej të luante. Kjo perspektivë e kundërt, *de jure* i ka munguar shkencës e *de facto* ajo është zbatuar gjithherë por si qasje ilegjitime.

Në aspektin metodologjik të hulumtimit shkencor, do të merret në shqyrtim roli i dyfishtë i rregullave metodike, të cilat edhe e ndihmojnë kërkimin të jetë i suksesshëm edhe e kthejnë atë në dogmë, duke e ngushtuar dhe kufizuar kërkimin për shkak të ekskluzivitetit të tyre dhe të lidhura me këto do të merren në konsideratë tensionet, kritikrat dhe zhvillimet metodologjike për ta bërë hulumtimin më efikas.

Qëllimi është që të tregohet se kundër-induksioni e plotëson një mungesë të madhe në qasjen metodologjike gjë që, sikurse do të argumentohet, e bën vetë hulumtimin shkencor më të hapur e të shpenguar.

Fjalë kyç: *rregulla të metodës, metoda kundër-induktive, Feyerabend, hulumtim, metodologji.*

Strumbullar i këtij shtjellimi është trajtimi i qasjes kundër-induktive, duke synuar argumentimin se zbatimi i kësaj metode ka një dimension thelbësor jo-dogmatik dhe një fuqi krijuese në hulumtimin shkencor.

Sikurse dihet, është një truizëm i njohur thënia se njohja shkencore është e pamundur pa instrumentet përkatëse, përkatësisht pa metoda të hulumtimit. E kjo domethënë se janë pikërisht këto instrumente shkencore, metodat dhe teknikat e ndryshme kërkimore, ato që i japin karakterin shkencor secilës njohje. Vlera e tyre qëndron te rigoroziteti që ato kanë, për shkak të rregullave që i përkufizojnë ato dhe të cilave duhet t'u përmbahen shkencëtarët kur i përdorin ato. Në këtë kuptim, rregullat metodike janë objektive, pra të vlefshme për të gjithë përdoruesit e tyre.

Krahas anës së vet pozitive, në praktikën shkencore ato shpërfaqin edhe anën e vet negative. Kjo e fundit e shprehur në mënyrë latente ndaj dhe më pak e rënë në sy, por që ekspozohet përmes faktit se rregullat metodike janë të ngurta dhe kanë kufizime. Rreptësia e rregullave, që i jep karakterin dogmatik metodave, jo rrallë ka shkaktuar pengesa në hulumtim dhe, për më tepër, asnjëra syresh nuk jep ndonjë sugjerim se si të kapërcehen ato. Rastet e këtilla kanë shkaktuar një debat të mprehtë (Karl Popper, 2002a; Thomas Kuhn, 1970; Paul Feyerabend, 1993; Imre Lakatos në Lakatos & Musgrave, 1970), duke rritur kuptueshmërinë se si nga pikëpamja metodologjike e gjeocentrizmit të bëhet e mundur marrja në konsideratë edhe heliocentrizmi, ose nga ky i fundit ndonjë alternativë tjetër.

Do të jetë Paul Feyerabendi i cili, në kryeveprën e tij *Kundër metodës* në vitin 1975, do ta sintetizojë tërë shqyrtimin filozofik e shkencor mbi metodologjinë: ai do të bëjë një pohim si askush përpara tij, duke ofruar një zgjidhje të panjohur teorikisht deri atëherë. Gjetjet e tij shembën besimin në rregullat e metodës, e për më tepër, ai, po ashtu, tregoi sa vlefshmërinë aq edhe

legjitimitetin e kundër-rregullave (Feyerabend, 1993, f. 14). Kurora e mendimit, në të cilin ai kishte arritur pas një shqyrtimi mbi dy dekadësh (të paktën prej artikullit debutues “Ngushëllim për specialistin” të vitit 1965 (Lakatos & Musgrave, 1970, f. 197-229) ishte kundër-induksioni.

Kjo perspektivë e kundërt metodologjike ofron qasjen alternative të hulumtimit, e cila e çliron nga ngurtësia e rregullave të metodës, të cilat e ngushtojnë shumë veprimtarinë shkencore, duke e konsideruar vetëm veprimin përkatës metodik si shkencor, dhe po ashtu, bashkë me të, edhe veprimtaria hulumtuese të jetë më e hapur dhe pa paragjykime ndaj ndonjë rregulli të metodës. Në këtë kuptim, metodologjikisht është po aq legjitim në aspektin shkencor marrja me një teori sa edhe marrja me një hipotezë kundër saj. Kjo është një qasje e re në kërkimin shkencor, që flak tutje dogmatizmin dhe intolerancën metodologjike, duke e bërë veprimtarinë shkencore jo-dogmatike dhe me një fuqi të madhe kreative.

Rigoroziteti i rregullave: dy anët e medaljes

Secila metodë i ka rregullat e veta të përcaktuara qartë, të cilat e karakterizojnë atë, si dhe tregojnë se si, sipas tyre, duhet të përdoret metoda e dhënë gjatë një studimi. Rregullat metodike janë rigorozë e precize dhe ekskluzive. Pikërisht për këtë, roli i tyre përgjithësisht është çmuar vendimtar për kërkimin, ashtu sikurse me të drejtë e ka përmbledhur Lekë Sokoli “Pa metoda shkencore nuk ka teori shkencore, pra nuk ka njohje shkencore” (Sokoli, 2013, f. 43). Imre Lakatos shkoi edhe më tej, duke theksuar se metodologjia dhe teoria janë shkrirë në një, gjegjësisht në metodologjinë e programeve të kërkimit shkencor (Lakatos në Lakatos & Musgrave, 1970, f. 132-138).

Ajo që më pak është theksuar është fakti se rregullat e metodës kanë një karakter të dyfishtë. Në njërën anë, ato përcaktojnë se çka lejohet të bëhet, me fjalë të tjera se si procedohet, për të arritur në një përfundim. Prandaj ndjekja e rregullave është e domosdoshme për atë që vepron sipas një metode të caktuar. Për shembull, janë rregullat ato që e përcaktojnë qasjen induktive ndryshe nga ç'e përcaktojnë qasjen deduktive, atë cilësore ndryshe nga ajo sasiore. Pikërisht rregullat e ndryshme janë ato të cilat edhe i dallojnë metodat nga njëra-tjetra, e kështu edhe qasjet e tyre. Për shembull, dihet se rregullat e metodës induktive përcaktojnë që hulumtimi të nisët nga vëzhgimet e rasteve individuale, të veçanta prej të cilave arrihet në një konkluzion të përgjithshëm (Rothchild, 2006, f. 2); kurse rregullat e metodës deduktive përcaktojnë një qasje të kundërt, se nga një premisë e pranuar dhe, në përputhje me të, nxirren hipoteza të cilat predikojnë të dhëna të veçanta, dhe në bazë të gjetjeve empirike konfirmohet ose hidhet poshtë hipoteza (Rothchild, 2006, f. 3). Janë rregullat ato që e përcaktojnë dhe e dallojnë metodën cilësore nga ajo sasiore (Cresswell, 2003, f. 84-102), si dhe llojet e tyre specifike të hulumtimit, për të kuptuar në thellësi, përkatësisht për të kuptuar në madhësi.

Kësisoj, rregullat e metodës tregojnë qartë se çfarë duhet bërë konform instruksioneve të tyre përkatëse, zbatimi rigoroz i të cilave e bën hulumtimin të mbështetur, duke i dhënë një karakter hetues sipas qasjes përkatëse. Në këtë kuptim flitet për hulumtim induktiv, ose deduktiv, ose cilësor, ose sasior etj. Dobishmëria e metodologjisë së hulumtimit është se saktësohet se si duhet të arrihet te evidencat e predikuara dhe kjo e bën hulumtimin të përqëndruar, këmbëngulës dhe zakonisht të suksesshëm. Por, pikërisht këtu, shpërfaqet edhe ana tjetër e medaljes: duke qenë se kërkohet zbatim rigoroz i rregullave

metodike hulumtimi bëhet i ngushtë e i kufizuar, disi dogmatik.

Karakteri dogmatik rrjedh nga rregullat e metodës, sipas të cilave janë të pranueshme vetëm të dhëna empirike që gjenden nga veprimi i përcaktuar metodologjik i kërkimit; ndërsa gjetjet të cilat nuk janë rrjedhojë e përmbushjes së atyre rregullave konsiderohen si të dhëna që nuk hyjnë në punë dhe që sipas metodës përkatëse nuk kanë kurrfarë peshe shkencore, ndaj dhe flaken tutje, ose injorohen, si gjetje pa ndonjë vlerë. Për shembull, duke bërë një hulumtim induktiv kërkohen vetëm evidenca konkrete që janë të njëjta për të mundësuar arritjen e konkluzionit (Papineau, 2005, f. 4), e çdo gjë që bie ndesh ose nuk është si ato, flaket si diçka e huaj, që nuk përputhet me konceptin. Hulumtimi deduktiv, pasi nga premisa formulohet një hipotezë, kërkon të gjenden vetëm të dhënat që predikon hipoteza. Dhe, sikurse e thekson Popperi, nëse gjetjet janë të përputhshme e konfirmojnë (përkohësisht) hipotezën, nëse gjetjet janë të kundërta me predikimin – atëherë përgënjeshtrohet hipoteza (Popper, 2002a, f. 55-56, 57-73). Si gjetjet e kundërta edhe mungesa e të dhënave të predikuara, që falsifikojnë një hipotezë mbeten jashtë vëmendjes metodologjike. Hulumtimi cilësor ka për qëllim kuptimin e hollësishëm të secilit rast, kurse kërkimi sasior ka për qëllim, në të kundërtën, kuptimin e madhësisë së objektit kërkimor (Creswell, 2003, 84-102) dhe përderisa për cilësoren mbetet jashtë interesimit sasia, për sasioren nuk paraqet ndonjë peshë vendimtare rasti i veçantë.

Sidoqoftë, praktika shkencore ka provuar padyshim se zbatimi i rregullave të metodës në raste konkrete është zakonisht shkencërisht i dobishëm, pasi që vë evidencën specifike empirike të nevojshme në fokusin e një kërkimi të caktuar. Shembuj të këtillë janë zbulimi i bozonit Higgz (Abazi, 2018, f. 58) dhe konstatimi i valëve gravitacionale (Abazi, 2018,

f. 59-60), për arritjen e të dyjave shkencëtarët kanë punuar për disa dekada. Shembujt si këta tregojnë se qasja këmbëngulëse dhe konsekuente është, natyrisht, ajo që ju jep vlerë rregullave të metodës. Por praktika shkencore, po ashtu, ka dëshmuar se gjatë hulumtimit, shpesh hasen gjetje (hipoteza dhe të dhëna) që nuk janë aspak në përputhje për fokusin e dhënë empirik dhe, përkundër këtij realiteti, asnjëra metodë (deri te konstituimi i kundër-induksionit) nuk jepte ndonjë sugjerim se çfarë të bëhet me ato gjetje, thjesht ato trajtoheshin dhe konsideroheshin apriori si gjetje të padobishme dhe jo shkencore. Kjo sjellje metodologjike, duke qenë e përcaktuar nga rregullat e metodës, në mënyrë latente merr karakter dogmatik, meqë qasjet e tjera alternative konsiderohen si jo legjitime e për këtë dhe jo shkencore, si dhe duke shkaktuar ngecje në kërkim.

Kritika ndaj metodave

Ngurtësia e rregullave metodike si pengesë është hetuar nga filozofë e shkencëtarë të ndryshëm dhe ajo është vënë në kudhër të kritikave, ndonjëherë më ashpër e ndonjëherë në mënyrë më të moderuar, prej nga gjithherë janë nxjerrë në shesh probleme serioze. Të gjithë kritikët e ndonjë metode ishin të përcaktuar për ndonjë metodë tjetër dhe kritikën e bënin nga ai pozicion metodologjik. Të parët qenë Thomas Kuhn dhe Paul Feyerabend që u shprehën përtej secilës metode, pa ndonjë pozicion të përcaktuar metodologjik.

Ndonëse trajektorja e kritikave ndaj metodave shkon ndër shekuj nëpër histori, këtu kryesisht do të mbahet parasysh debati bashkëkohor, debat i cili ndonjëherë eskaloi deri në argumentim për ndonjë metodë si qasje jo-shkencore, siç bëri Karl Popperit në të mirënjohurën *Logjika e zbulimit shkencor* në

vitin 1935 kundër metodës induktive (Popper, 2002a, f. 3-17). Kur pozitivizmi logjik ishte në kulm në të '30-tat e shekullit XX, metoda induktive ishte identifikuar si metodë nëse jo e vetme atëherë të paktën kryesore shkencore në disiplinat natyrore; në frekuenca të tilla ishin shumica e filozofëve të shkencës dhe shkencëtarëve, ndër të cilët Moritz Schlick, Otto Neurath, Hans Han, Rudolf Carnap etj. Vetëm Karl Popperi pati një këndvështrim tjetër, duke e kritikuar ashpër qasjen e pozitivizmit logjik (Popper, 2002a, f. 3-17, 248-268) dhe këtej edhe e nxjerr përfundimin se induksioni çon "ose në regres të pafund, ose në doktrinën e *apriorizmit!*" (ibid., f, 6).

Sigurisht, Popperi nuk e linte shkencën pa metodë. Avokimi i tij i fuqishëm ishte për metodën deduktive (Popper, 2002a, f. 10), e cila sikurse ai besonte, ishte e vetmja metodë e mirëfilltë shkencore (ibid.). Mirëpo, pikërisht këtë metodë do ta godasë në zemër Bertrand Russell. Duke folur për veprën *Elementet* të Euklidit, të cilën e quan librin më të shkëlqyer të shkruar ndonjëherë dhe një prej monumenteve të përkryera të intelektit grek, ai shpreh një kritikë shumë të mprehtë. Sipas Russell, vepra madhështore e Euklidit "kishte, natyrisht, kufizimin tipik grek: metoda është e kulluar deduktive, dhe nuk ka ndonjë mënyrë, brenda saj, të testimit të supozimeve pikënisëse" (Russell, 2003, f. 221), pasi supozimet e tilla, duke u konsideruar si premisat kryesore, pra si teori të vërteta, konsideroheshin të padiskutueshme. Ajo që Russell donte të thoshte ishte kjo: testimet e propozicioneve konkrete bëhen mbështetur në supozimet thelbësore të teorisë, por defekti qëndron te ajo se pikërisht këto supozime thelbësore, ndonëse merren si të vërteta, mund të jenë të gabuara, ashtu sikurse, për shembull në shekullin e XIX u tregua se supozimet thelbësore të veprës së Euklidit mund të ishin të gabuara dhe se vetëm vëzhgimet mund të vendosnin nëse ato ishin ashtu (Russell, 2003, f. 221) Kjo kritikë e qëlluar e Russell mbështetet edhe nga historia e

shkencës: afërsisht nga shekulli i tretë para erës së re shumica e filozofëve dhe shkencëtarëve të astronomisë e kishin konsideruar të vërtetë supozimin pikënisës të teorisë gjeocentrike mbi tokën si qendër të universit dhe astronomët ishin udhëhequr ndër shekuj në punën e tyre shkencore nga ai “supozim pikënisës”, i cili u tregua të ishte i gabuar. Ose një shembull nga shkencat sociale: supozimi themelor i socializmit ishte vendosja e drejtësisë sociale si barazi në mirëqenie të të gjithë qytetarëve, që po ashtu ishte treguar e gabuar (tashmë dihet se pas disa dekadash “eksperimentimi” - në Rusi e në vendet e tjera - realiteti social në vendet ish-socialiste tregoi të kundërtën, se ishte rritur e thelluar padrejtësia sociale dhe pabarazia në mirëqenie, me rrjedhimin se ishin varfëruar e shndërruar në skllëvër masat punonjëse e fshatare, kurse klasa burokratike e teknokratike dhe kasta e partiakëve ishte pasuruar e shndërruar në sundimtar).

Pavarësisht kritikave të ndërsjella nga filozofë që besonin si më shkencore njërën nga metodat, njëlloj si për metodën induktive e atë deduktive edhe për atë sasiore e cilësore, si dhe për çdo metodë tjetër, përvoja shkencore, sikurse thekson Steven Eric Krauss, tregoi se asnjëra metodë nuk është më shkencore se tjetra (Krauss, 2005, f. 758-761). Ky perceptim është mjaft i gjerë. Metodat me të cilat shërbehen hulumtuesit janë të shumta e nga më të ndryshmet, pavarësisht kësaj shumësie - theksohet në Enciklopedinë filozofike të Routledge, që të gjitha janë metoda shkencore (REP, 1998, f. 7769-7773).

Kritikat ndaj metodave të ndryshme kanë dhënë fryte të dobishme për shkencën. Sikurse e ka theksuar Krauss, kritikrat kanë çuar në përmirësime që kanë bërë të mundur kuptueshmërinë më të mirë të secilës mënyrë të hulumtimit dhe të mundësive të ndërthurjes së tyre (Krauss, 2005, f. 761-762). Në shkencat shoqërore, si pasojë e kufizimeve dhe pamjaftueshmërisë në përdorimin si instrument kërkimor

vetëm të metodës cilësore ose vetëm të asaj sasiore, ka lindur nevoja për kombinimin e tyre dhe tash kjo (metodë e përzier) përdoret gjerësisht, e për më tepër konsiderohet si “alternativë legjitime” edhe në mjekësi, madje duke gjetur përdorim të gjerë (Doyle, Brady & Bryne, 2009, f. 175.) Metoda e përzier do të nisë së voni, në mesin e shekullit të XX, kurse gjerësisht nga viti 1980 (McKim, 2017, f. 202). Dhe sipas të njëjtit autor, metoda e përzier tashmë përdoret nga studiues të mirënjohur si Creswell, J. W. (2003), Creswell, J. W., & Plano Clark, V. L. (2007), Dunning, H., Williams, A., Abonyi, S., & Crooks, V. (2008) etj. Kur të konstituohen njëherë rregullat metodike ato ndryshohen me vështirësi dhe në një proces të gjatë, mjaft kompleks, me argumentime të kundërta dhe shoqëruar me tensione filozofike. Si ilustrim mund të merret debati që ka shkaktuar problemi i induksionit: ai u bë një sfidë për të gjetur zgjidhje ndaj tij dhe për ta tejkaluar atë. Disa prej përpjekjeve kryesore të kësaj ndërmarrjeje mund të shihen edhe te *Metodologjia* e Papineau (2005, f. 8-13), ku parashtrohet zgjidhja që pretendoi Popperi përmes eliminimit të vetë induksionit si metodë dhe alternativën përmes testimit deduktiv në kërkimin shkencor. Mandej problemi i ri i induksionit i Goodmanit si problem i dallimit të predikateve “të projektueshme” (ato që janë të rrënjosura në praktikën, përkatësisht që i ka përdorur komuniteti njerëzor për të nxjerrë përfundime induktive në të kaluarën) nga ato të “jo-projektueshme” (Papineau, 2005, f. 19-22). Mbi këtë bazë, Papineau (2005, f. 13-19, 60-72) i bën një mbrojtje metodës induktive, duke zgjeruar dhe shpjeguar disa aspekte, të cilat, megjithatë, argumentojnë se kjo metodë është e dobishme në hulumtimin shkencor. Kritika të ngjashme, për dhe kundër metodës induktive dhe deduktive, mund të gjenden gjithandej (Rotchild, 2006; Medewar, 1996; Popper 2002a; Ayer, 1971).

Për dallim nga të gjithë kritikët e mësipërm, në kritikën ndaj rigorozitetit dhe karakterit të ngushtë të rregullave metodike Thomas Kuhn ka parashtruar një këndvështrim tjetër, atë se nuk ka kritere, në kuptimin e rregullave të ndonjë metode, e as ndonjë metodologji që të jenë me vlefshmëri universale, ashtu që paraprakisht të specifikonin statusin e një teorie (Kuhn në Lakatos & Musgrave, 1970, f. 19, 237). Këtë ai e argumentoi përmes faktit se nuk kishte rregull metodologjik që të ishin më të vlefshme se sa teoria: “Paradigmat mund të jenë më me përparësi, më detyruese dhe më të plota sesa çdo tufë rregullash për hulumtim që mund të abstraktohen në mënyrë të qartë prej tyre (Kuhn, 1970, f. 46). Në këtë drejtim, Feyerabend shkoi edhe më tutje duke theksuar se “*të gjitha metodologjitë, edhe ato më të qartat të mundshme, i kanë limitet e veta*” (Feyerabend, 1993, f. 23)

Përpyekjet për të gjetur rregulla të duhura kërkimore

Të nxitur nga praktika shkencore dhe vështirësitë e shkaktuara nga rregullat e metodave shkencëtarët e filozofët kanë hetuar te rregullat metodike herë një pengesë e herë një tjetër, herë nevojën për të begatuar qasjen e herë për ta ndryshuar fare. Këto ndërmarrje shprehin përpjekjen për të gjetur rregulla të përshtatshme për hulumtimin, që të tejkalohen kufizimet e tyre dhe të shmanget vendnumërimi.

Një shqyrtim të këtillë, para shumë shekujsh, e ka bërë Francis Bacon. Në kohën kur metoda induktive ishte në kulmin e saj me konsiderata si instrument shkencor, Bacon e kishte theksuar, që në veprën *Novum Organum* publikuar në vitin 1620, se duke synuar vetëm instancat pozitive, ajo qasje ishte e mangët. Sipas Milton, Bacon kishte kuptuar te qasja induktive se, që të funksiononte sipas pretendimit, do të mund të kishte

përfitime nga të dyja instancat, si ato pozitive, ashtu edhe ato negative (Milton, 1998, f. 766; Bacon, 1902, f. 130). Kjo e bëri Baconin të konstatonte se, për të mos mbetur i izoluar në kornizën konceptuale, nga secili studiues do të duhej të ndiqeshin dy rregulla: (i) të mënjanohej mendimet dhe nocionet e pranuar dhe (ii) të përmbahen nga përgjithësimet (Bacon, 1902, f. 106-107).

Kontributi si ky nuk ishte as i vetmi e as i izoluar. Përkundrazi. Shkencat, të udhëhequra nga rregulla rigorozet metodologjike dhe pikërisht për shkak të tyre, vazhdimisht hasin në hipoteza ose të dhëna që nuk mund të akomodohen dot në kornizën e përgjithshme teorike sikundër është paradigma. Këto gjetje të pamundura për t'u bërë pjesë e integruar natyrshëm e kornizës teorike quhen anomali (Kuhn, 1970, f. 52; Lakatos, 1989, f. 53; Feyerabend, 1993, f. 11-12), dhe për këtë arsye mbeten jashtë konsideratave hulumtuese.

Duke kuptuar kufizimet e rregullave, filozofët e shkencës dhe shkencëtarët e ndryshëm u përpoqën të gjenin një qasje më të hapur, jo-dogmatike, që do të bënte metodologjikisht kërkimin më efikas. Pozitivistët logjikë nga pikëpamja e rregullave të verifikimit i konceptonin si anomalike disa pohime që haseshin në shkenca, siç janë "pohime të pakuptimta" dhe pohimet metafizike që konsideroheshin të zbrazëta (Ayer, 1959, f. 145). Sipas tyre, pohimet metafizike nuk referonin asgjëkund në realitet ndaj dhe, si jo shkencore ose pseudo-shkencore, duhej të spastroheshin nga oborri i shkencave, ashtu që shkencëtarët të mund të punonin vetëm me predikimet empirike. Por, megjithëse kishin qëllim të mirë, po të zbatonin shkencëtarët me rigorozitet këtë rregull metodologjik të pozitivistëve logjik kundër pohimeve metafizike, rezultati do të ishte krejt i kundërt. Duke eliminuar të gjitha pohimet që nuk referonin në realitetin empirik, atëherë do të eliminoheshin edhe vetë rregullat metodologjike të

pozitivistëve logjikë meqë ato ishin “pohime të pakuptimta, gjë që, sikurse ka pohuar me të drejtë Karl Popperi, rezultati do të ishte eliminimi i vetë shkencës (Popper, 2002a, f. 14).

Për ta zgjidhur problemin metodologjik që kishin sjellë pozitivistët logjik, Karl Popperi parashtroi një qasje tjetër, të cilën e besoi të përputhshme me praktikën shkencore. Rregullat metodologjike të konstruara nga ai ishin shumë më liberale. Asnjë pohim nuk duhej të paragjykohej paraprakisht. Rregullat metodologjike përcaktonin testimin e teorive, testim ky që ishte i dyfishtë: në njërën anë ballafaqohej teoria me teorinë dhe në anën tjetër, secila prej tyre ballafaqohej me evidencat empirike. Krejt në fund, statusi i secilës teori përcaktohej nga rezultatet e eksperimentit. Për ta përmbledhur të tërën, Popperi thekson se qëllimi metodologjik i shkencëtarëve duhej të ishte gjetja dhe eliminimi i teorive të rreme (Popper, 2002b, f. 19, 66-67).

Metodologjia e falsifikimit e Popperit sikur e pastronte oborrin e shkencës nga frutat mashtruese teorike, të cilat dukeshin si të vërteta e nuk ishin. Por rregullat e tilla, në të vërtetë, do të kishin efekt krejt të kundërt, që e kishte argumentuar Thomas Kuhn qysh në veprën e tij të mirënjohur *Struktura e Revolucioneve Shkencore* botuar më 1962. Sipas Kuhnit, teoritë e reja gjithnjë kanë më pak mbështetje në evidencat empirike krahasuar me teoritë e vjetra, prandaj rregullat metodologjike të falsifikimit, njëlloj si ato të verifikimit, e madje edhe po të merren të kombinuara si verifikim-falsifikim (Kuhn, 1970, f. 146-147) nuk do t'i jepnin metodologjikisht rezultatet e pretenduara.

Debati i filozofëve dhe i shkencëtarëve gjithnjë kishte nxjerrë në pah kufizime të caktuara të rregullave metodologjike dhe efektet e tyre negative. Kontributet e tyre, përmes qasjeve kritike, kishin për qëllim hapjen e rrugës së ndryshimeve të rregullave të metodave, ashtu që ato të bëheshin më të përputhshme me praktikën shkencore. Shpresa për të gjetur

rregulla të duhura ishte kthyer në mit, pasi që, pas çdo ndryshimi korrektues, gjithnjë ishte bërë e qartë se rregullat, sado elastike të bëheshin, përsëri ishin të mangëta dhe kishin kufizime. Këtë e kishte shprehur bindshëm Thomas Kuhn, i cili kishte theksuar se nuk ka metodologji, rregulla apo kritere që të kenë vlefshmëri universale, se vlefshmëria e tyre ishte e kufizuar vetëm brenda një paradigme të dhënë. Madje, ai kishte theksuar se krahasuar me çdo rregull a kriter, ishte paradigma ajo e cila kishte përparësi (Kuhn, 1970, f. 46). Duke i sintetizuar të gjitha këto, Lakatos konstrukttoi një metodologji të shkrirë në teori, në kuptimin e tij si program i kërkimit shkencor (e ngjashme me paradigmen e Kuhnit), me kritere shumë tolerante si ai i përparim-zvetënimit, por që në fund, kishte konstatuar vetë se ky kriter vlente vetëm post hoc (Lakatos, 1989, f. 112).

Tërë kjo trajektore e përpjekjeve për të gjetur rregulla të duhura dhe dështimi i vazhdueshëm i çdo rregulle për të qenë sikurse pretendohet e kishin bërë Paul Feyerabendin që të kuptonte se nuk ka dhe nuk mund të ketë ndonjë rregull të tillë metodologjik që të jetë tërësisht i vlefshëm për kërkimin shkencor. Ndaj ai e kishte shprehur mangësinë kryesore të deriatëhershme, e cila mund të shihej nga perspektiva e kundërt metodologjike. Nga kjo pozitë ai mund të nxirrte përfundimin se

...nuk ekziston një rregull i vetëm sado i bindshëm të duket, dhe sado i mirë-bazuar në epistemologji, që nuk është shkelur në ndonjë kohë apo tjetër. Bëhet e qartë se shkeljet e tilla nuk janë ngjarje aksidentale, nuk janë rezultat i njohurive të pamjaftueshme ose të moskujdesit që mund të ishte shmangur (Feyerabend, 1993, f.14)

Kundër-induksioni - një metodë e re, e ndryshme

Një mësim të duhur kishte nxjerrë Feyerabendi nga historia e shkencës, që e kishte bërë të shihte kërkimin shkencor nga pozitat e perspektivës së kundër-rregullave. Mësimi ishte ky:

... duke pasur parasysh çdo rregull, sado 'themelor' ose 'racional' të jetë, ka gjithmonë rrethana kur këshillohet jo vetëm që të injorohet rregulli, por të bëhet e kundërta e saj (Feyerabend, 1993, f. 14).

Në këtë këndvështrim ai formuloi parimin e “everything goes” (Feyerabend, 1993, f. 19), ku mbështetet qasja kundër-induktive (Feyerabend, 1993, f. 20).

Feyerabendi kishte kuptuar se mungesa e perspektivës së kundërt kishte ngulfatur kërkimet shkencore, duke e ngushtuar atë dhe duke e zvogëluar atë, ashtu që rregullat dominuese duhet të thyheshin një herë, për të bërë të mundur gjetjen e zgjidhjes. Kërkimi shkencor duhej të çlirohej metodologjikisht, e kjo mund të bëhej sipas Feyerabend duke e legjitimuar edhe qasjen e kundërt me rregullat, përkatësisht kundër-rregullat. E pikërisht këtë ai ia dhuroi si kontribut shkencës: kundër-induksionin. Kjo metodë do ta bënte të hapur metodologjikisht qasjen dhe shkencën do ta bënte po ashtu më efikase në hulumtimin e realitetit, meqë kërkimi i dijes nuk do të kufizohej ekskluzivisht nga rregullat eliminuese dhe gjithçka do të mund të vihej në fokusin e shkencës si e denjë për hulumtim po qe se ndonjë ekip shkencëtarësh do ta shihte të udhës.

Atëherë, si do të funksionojë kjo risi metodologjike që solli Feyerabendi?

Kundër-induksioni, sikurse e tregon vetë emri i tij, është një qasje që legjitimon çdo pretendim shkencor sado të jetë në kundërshtim me teorinë mbisunduese. Ajo sugjeron, në njërën

anë, “kundër-rregullin që nxit të zhvillohen hipoteza në kundërshtim me teoritë e pranuar dhe shumë të konfirmuara” dhe në anën tjetër, “kundër-rregullin që nxit të zhvillohen hipoteza në kundërshtim me faktet e mirë-etabluara” (Feyerabend, 1993, f. 20).

Përderisa secila metodë kërkon krijimin e hipotezave që nuk bien ndesh me teoritë e mirë-konfirmuara dhe të zhvillohen hipoteza që nuk bien ndesh me faktet e mirë-etabluara, metoda e Feyerabendit kërkon të bëhet e kundërta. Kjo do të thotë se kur ekzistojnë hipoteza që bien ndesh me teoritë apo faktet shkencore, kundër-induksioni sugjeron jo eliminimin e tyre, por kthimin e fokusit kah to; e në mungesë të hipotezave të kundërta, ajo sugjeron hartimin e tyre.

Për të shquar më mirë kuptimin e kësaj, le të silllet ndërmend se, sipas rregullave, hulumtimi induktiv kërkon të dhëna që janë krejtësisht të ngjashme, të cilat formojnë një klasë të caktuar, në të cilën nuk mund të futet asgjë tjetër, përpos pjesëtarëve të klasës së caktuar sipas përkufizimit. Kjo është mënyra tipike e veprimit sipas qasjes induktive dhe kjo nuk mund të ndryshohet, për aq sa dëshirohet të mbetet përfundim përmes induksionit. Po kjo, në thelb, ndodh edhe me metodën deduktive, sipas së cilës, të pranueshme janë vetëm rastet specifike që janë në pajtim dhe të përputhshme me premisën e saj themelore (teorinë, ligjin), kurse rastet e tjera eliminohen. E njëjta vlen edhe për qasjen sasiore, si dhe për qasjen cilësore, si edhe për të gjitha metodat e tjera, të cilat duhet të ndjekin rregullat e tyre që të mbeten hulumtime të denja për emrin. Për ndryshim nga të gjitha metodat, metoda e kundër-induksionit e ka në fokus të vetin atë që dallon e që është e ndryshme, atë që bie ndesh me rregullat sipas të cilave bëhet një kërkim, atë që nuk futet dot në kornizën konceptuale të metodologjisë me rregulla të rrepta e eliminuese, atë që është e kundërt me to.

Kësisoj, duke e ngritur qasjen kundër-induktive në rregull metodologjik, Feyerabendi ka kontribuar që shkencëtarët të mos bien pre e kornizave dogmatike të ngurtësisë së rregullave metodike, që i bëjnë të injorojnë, të shpërfillin e madje edhe ta konsiderojnë si absurde ndonjë hipotezë apo evidencë empirike vetëm pse e përjashtojnë rregullat metodologjike. Në këtë kuptim, rrjedhimi i kundër-induksionit është se shkenca bëhet më e hapur dhe më e lirë në kërkimin për të njohur realitetin. Kjo është arsyeja pse kundër-induksioni është një alternativë për të dalë nga ngecja e hulumtimit, në të cilën mund ta sjellin kërkimin rregullat e rrepta të metodës; një alternativë për të ndryshuar kursin kërkimor në një mënyrë të butë dhe me pasoja minimale.

Qasja kundër-induktive nuk ndalon që shkencëtarët të veprojnë sipas rregullave metodike që ekipet hulumtuese mund t'i konsiderojnë të duhura dhe të udhëhiqen nga to. Përkundrazi: po qe se një kundër-hipotezë, për t'u zhvilluar deri në një teori do të kërkonte, fjala vjen, përdorimin e qasjes induktive ose deduktive, kjo do të ishte krejt në rregull. Ajo që, në të vërtetë, konsiston qasja kundër-induktive është e drejta që të lejohet veprimi i shkencëtarëve të aplikojnë rregulla të tjera, në ndonjë rast kur i konsiderojnë të duhura. Kjo do të thotë që të lejohet mundësia, pa ndonjë pasoja, të veprohet kundër koncepteve standarde metodike, të cilat kërkojnë ekskluzivisht një qasje konsekuente dhe në përputhje me to, duke përjashtuar dhe ndaluar çdo qasje tjetër. Bërja legjitime e qasjes në kundërshtim me rregullat e metodës së aplikuar, do të thotë një kundër-veprim i tillë shpreh kërkimin kundër-induktiv. Qëllimi është që shkencëtarët të mos i prejudikojnë disa instrumente shkencore, në kuptimin e ekskluzivitetit të tyre, por të lejohet përdorimi i secilit rregull e secilës metodë që do të mund ta bënte kërkimin të frytshëm shkencërisht, për të arritur njohje empirike. Me fjalë të tjera, kundër-induksioni nuk kërkon

dominancë, as ekskluzivitet si i vetmi i vlefshëm ose më i vlefshëm në përgjithësi, por kërkon legjitimitet si një instrument shkencor, ashtu si të gjitha metodat e tjera kërkimore që shkencëtarët të mund ta përdorin kur ndonjë instrument tjetër nuk e jep rezultatin e pritshëm ose pengon t'i arrijë ato, ose thjesht e konsideron qasjen kundër-induktive që mund të arrijë njohjen e realitetit që nuk mund të bëhet me ndonjë metodë tjetër.

Atëherë, bëhet e qartë se vetëm kur të nënkuptohet se nuk është vetëm ndonjë lloj metode me karakter shkencor, por se secila metodë dhe pa përjashtuar asnjërën, përfshi edhe metodën kundër-induktive, që mundëson hulumtim të frytshëm është me karakter shkencor. Në këtë kuptim, nuk është me rëndësi vendimtare vetëm një metodologji e caktuar, por cilado qoftë që mundëson kërkim të suksesshëm kur ndonjë metodologji tjetër nuk e bën këtë të mundur. Vetëm duke e pasur këtë parasysh, domethënë në një kontekst të këtillë, thënia e mësipërme (Sokoli, 2013, f. 43) bëhet kuptimplote: njëmend nuk ka dije shkencore pa një metodë shkencore, cilado qoftë ajo, e cila kërkimin e bën të suksesshëm.

Kundër-induksioni si një qasje alternative metodologjike

Për të treguar funksionalitetin dhe qasjen e hapur të kundër-induksionit, Feyerabend ka sjellë si ilustrim inkuizionin kundrejt Galileo Galileut (Feyerabend, 1993, f. 77-146). Në kohën e Galileut, rregullat mbisunduese metodologjike të astronomisë gjeocentrike ndalonin çdo qasje tjetër ose të kundërt. Nga ngushtësia e rregullave metodologjike ishte e papranueshme ndonjë hipotezë që binte ndesh me gjeocentrizmin, si dhe çdo gjetje empirike që nuk mund të akomodohej përmes rregullave metodike me atë realitet

astronomik. Të tilla hipoteza e të tilla gjetje ishin ilegjitime, ato ndaloheshin metodologjikisht dhe konsideroheshin joshkencore. Metodologjia gjeocentrike kishte prodhuar njohuri të astronomisë bazuar në vizionin gjeocentrik, prandaj ishte e ndaluar të veprohej ndryshe përveç se në përputhje me rregullat e saj. Nëse do të zbatohej me rreptësi metodologjia gjeocentrike, do të kundërshtohej gjithçka që është në kundërshtim ose në shpërputhje me të, dhe, pas përpjekjesh, nëse nuk do të akomodohej, do të flakeshin si të papajtueshme.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkencat sociale, konkretisht duke ndjekur shembullin e mëhershëm të socializmit. Rregullat metodologjike të socializmit i pranonin vetëm hipotezat që ishin në përputhje me rendin socialist, si dhe gjetjet empirike që ishin konform predikimeve teorike të socializmit. Ato nuk pranojnë asnjë hipotezë e cila nuk mund të bëhet e përputhshme me rregullat socialiste dhe asnjë gjetje që minon predikimet socialiste, madje do të trajtohej si të paligjshme për shkak se ndaloheshin metodologjikisht. Fundi i tyre do të ishte i njohur: pas përpjekjeve të pasuksesshme për t'i akomoduar në kornizën teorike të socializmit, ato do të përjashtoheshin metodologjikisht si anomali.

Në asnjërin shembull të mësipërm, tradicionalisht nuk do të kishte legjitimitet tjetër, përpos rregullave metodologjike që sundonin. Dhe ato nuk do të lejonin asgjë që binte ndesh me to, madje do të eliminonin çdo gjetje të papajtueshme. Rregullat metodologjike janë gardianë që përzgjedhin çka është e pranueshme e çka nuk është. Po t'u përmbaheshin atyre rreptësishtë komunitetet përkatëse, atëherë edhe astronomia gjeocentrike edhe socializmi do të mbeteshin të përjetshme. Kështu, rregullat e tilla metodologjike shndërrohen në konservatore dhe dogmatike, që një situatë të caktuar

shkencore apo shoqërore e kthejnë në një gjendje të pandryshuar, domethënë të dhënë një herë e përgjithmonë.

Sigurisht, dalja nga kjo gjendje është e mundur. Feyerabendi ka treguar se ndryshimet vijnë zakonisht duke i thyer rregullat ekzistuese (Feyerabend, 1993, f. 14). Duke e kuptuar se veprimet e tilla janë të domosdoshme historikisht, Feyerabend e konstituroi kundër-rregullin si metodë (Feyerabend, 1993, f. 20). Parimi kryesor është se në kohën kur rregullat shndërrohen në pengues dhe bëhen të dëmshme për kërkimin, atëherë do të ishte e duhur të veprimej sipas kundër-induksionit. Kundër-induksioni është rregull metodik i veprimit alternativ, që domethënë se nëse një rregull e tkurr kërkimin njohës deri në frenim, atëherë qasja alternative duhet të konsiderohet si legjitim dhe kërkim shkencor.

Kështu, duke e pranuar si një nga metodologjitë shkencore kundër-induksionin, atëherë askush nuk do të kishte mbështetje metodologjike për të kundërshtuar ndonjë ekip shkencëtarësh që në fokus të tyre vënë teori alternative, ose që merren me hulumtimin e predikimeve të ndonjë hipoteze që bie ndesh me paradigmen dominuese, apo që merret me ndonjë gjetje empirike që bie ndesh me faktet apo realitetin ashtu sikundër njihet ai. Rregullat e kundër-induksionit e çlirojnë shkencën nga kufizimet metodologjike dhe e kthejnë në fokus kryesor njohjen e realitetit, respektivisht aspektin epistemologjik.

Përmbyllje

Nga sa u parashtrua deri këtu, shihet se shkenca ka evoluar edhe sa i përket aspektit metodologjik të hulumtimit. Kryesisht nga përvoja në veprimtarinë shkencore, është bërë e qartë se të gjitha rregullat e metodave në ndonjë moment të

caktuar të hulumtimit janë treguar të ngurta dhe janë kthyer në penguese të hulumtimit me sukses, duke e frenuar atë. Se ka ndodhur kështu u tregua me shembuj të paktë por të rëndësishëm nga shkenca natyrore dhe shoqërore, me të cilët u qartësua fakti se zbatimi me rreptësi i rregullave metodike në ndonjë moment të caktuar mund të kthehet kundër vetë natyrës së hulumtimit, meqë e shtrëngon t'i përmbahet njohjes së caktuar të realitetit duke mos lejuar njohje të tjera të mundshme të realiteti ashtu sikurse mund të jetë ai.

Zbatimi me konsekuencë i rregullave metodike, shkakton herë pas here vendnumërim në hulumtim, nga se dogmatizmit latent i detyron mbetjen në kornizat e rregullave. Ndonëse shumë filozofë e shkencëtarë kanë dhënë kontribute për liberalizimin e rregullave të metodave, do të jetë pikërisht Paul Feyerabend, i cili do ta kuptojë saktë veprimin praktik të shkencëtarëve, domethënë se si e kanë kaluar vendnumërimin e hulumtimit. Kjo rezultoi me zgjidhjen e panjohur teorike deri atëherë: kundër-induksionin. Shkenca e plotësuar edhe me këtë metodë që i ka munguar, e ka tashmë arsenalin e tërë metodik për të mos mbetur pre e kornizave metodologjike. Me Feyerabendin është bërë teorikisht legjitim veprimi alternativ, përmes kundër-induksionit. Shkenca e ka hequr pengesën metodike dhe tani ajo vërtet është liberalizuar metodologjikisht.

Referencat

Abazi, H. (2018). *Shkenca në (r)evolucion. Refleksione mbi kërkimin, arritjet, teknologjinë, sfidat dhe transformimet shkencore*. Prishtinë: Kolegji AAB.

Ayer, A. (1971) *Language, truth and Logic*. London: Pinguin Books.

Ayer, A. (ed). (1959). *Logical positivism*. New York: The Free Press; Cambridge University Press: Cambridge.

Bacon, F. (1902). *Novum Organum*. New York: P. F. Collier & Son,

Feyerabend, P. (1975) *Against Method*. London & New York: Verso.

Creswell, J. W. (2003). *Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches* (2nd ed.). Thousand Oaks, CA: Sage.

Creswell, J. W., & Plano Clark, V. L. (2007). *Designing and conducting mixed methods research*. Thousand Oaks, CA: Sage. (second edition, 2011)

Dunning, H., Williams, A., Abonyi, S., & Crooks, V. (2008). "A mixed method approach to quality of life research: A case study approach". *Social Indicators Research*, 85, 145-158.

Doyle, L., Brady, A.-M. & Bryne, G. (2009). "An overview of mixed methods research". *Jurnal of Reserach in Nursing*, Los ANgeles, London etc.: Sage.

Krauss, S. E., "Research Paradigms and Meaning Making: A Primer", *The Qualitative Report*, Volume 10, Number 4, December 2005, nënkapitulli "Comparative Epistemologies: Qualitative "versus" Quantitative Research Paradigms"; nënkapitulli "Realism: The Qualitative and Quantitative as Complementary".

Kuhn, Th. (1970). *The Structure of Scientific revolutions*. Second Edition. Enlarged. Chicago & London: University of Chicago Press.

Lakatos, I. (1989). *The Methodology of Scientific Research Programmes*. Cambridge etc.: Cambridge University Press.

Lakatos, I. & Musgrave, A. (ed). (1970). *Criticism and The Growth of Knowledge*. Proceedings of the International Colloquium in the Philosophy of Science, London, 1965. Volume 4, Cambridge at the University Press.

McKim, C. A. (2017). "The Value of Mixed Methods Research: A Mixed Methods Study". *Journal of Mixed Methods Research*. USA: Sage.

Milton, J. R. (1998). "Francis Bacon". Në *Routledge Encyclopedia of Philosophy*, Version 1.0, London and New York: Routledge.

Medewar P. (1996) *Is the scientific paper a fraud?* In: *The Strange Case of the Spotted Mice and Other Essays*. Cambridge: Oxford U. Press.

Papineau, D. (2005). *Metodologjia: Elementet e filozofisë së shkencës*. Prishtinë: Fryma e filozofisë.

Popper, K. (2002a). *The Logic of Scientific Discovery*. London: Routledge classics.

Popper, K. (2002b). *Conjectures and Refutations*. London & New York: Routledge Classics.

REP. (1998) - REP - *Routledge Encyclopedia of Philosophy*, Version 1.0, London and New York: Routledge.

Rothchild, I. (2006). "Induction, deduction and the scientific method. An eclectic overview of the practice of science". the Society for the Study of Reproduction, Inc.

Russell, B. (2003). *History of Western Philosophy*. London & New York: Routledge Taylor & Francis Group.

Sokoli, L. (2013). *Metodat e kërkimit shkencor*. Instituti i Sociologjisë, Tiranë.